

Të enjten, më 7 maj, m në kuadër të "Javës Kulturore Shqiptare" në Dyseldorf

Shfaqet premiera gjermane e filmit shqiptar "Koha e kometës"

Filmi shqiptar, "Koha e kometës", bazuar në romanin "Viti i Mbrapshtë" i Ismail Kadaresë, do të shfaqet tani edhe në Gjermani, si pjesë e rrugëtimit të tij pasi është shfaqur me kohë në trojet mbarëshqiptare.

Pas vlerësimit si "filmi më i mirë shqiptar" në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit, që u mbajt në Durrës, filmi "Koha e kometës" i regjisorit Fatmir Koçi tani do të shfaqet në kuadër të javës kulturore shqiptare edhe në Dyseldorf të Gjermanisë. Filmi ka përjetuar vlerësime të larta nga kritika dhe po ashtu është mirëpritur në mënyrën më të shkëlqyer nga ana e publikut. Tregues më i mirë për këtë është fakti se filmi i theu të gjitha rekordet e shikueshmërisë së tetë viteve në Prishtinë me gjith-



sej mbi 10 mijë shikues.

Ngjarjet e filmit zhvillohen në vitin 1914 në kohën kur fuqitë e mëdha angazhojnë një princ të huaj që të udhëheqë Shqipërinë. Këto vite të turbullta për-

shkruhen në librin e shkrimtarit të madh Ismail Kadare "Viti i Mbrapshtë", mbi të cilin është bazuar edhe skenari i filmit, një bashkëprodhim me kompaninë LARA Enterprises.

Info

7 Maj në ora 18.00. Black Box/Kino im Filmmuseum, Schulstraße 4, 40231 Düsseldorf. Telefon 0211/899 22 32. www.duesseldorf.de/film-museum

Berlin: FC Liria - Berliner SV 92 2:1 (1:0)

Isuf Pepshi shënoi golin e tij të treqind të karrierës!

FC Liria: Irfan Jerliu (3), Nazim Jahaj (3), Përparim Halimi (3), Besim Hyseni (4) (Menderes Rexha), Musa Shkreta (2,5), Lavdim Demiri (3), Kujtim Kolloni (3) (Bashkim Beqiri), Fabian Përdedaj (3), Basri Dervishi (3), Burim Restelica (3) dhe Isuf Pepshi (2,5). Trajner: Arsim Hyseni nd. Xhemajl Elezi. Golashënuesit: Isuf Pepshi min. 18 dhe Basri Dervishi min. 65.



Goli jubilar, i 300-të, i Pepshit

Bislim Selmani

Skuadra shqiptare këtë fundjavë zhvilloi ndeshjen kundër skuadrës gjermane Berliner SV 92. Ishte kjo krye ndeshje e skuadrave të rrezikuara. Skuadra jonë, duke ditur rëndësinë e këtij takimi, ndeshjen e filloi me maturi, duke kontrolluar me kujdes çdo pëllëmbë të fushës, dhe me hapa të koncentruar atakonte portën kundërshtare. Si rrjedhojë, erdhi edhe goli i shumë prituri, i cili ishte goli jubilar, i treqindti që e shënoi legjenda e këtij klubi, Isuf Pepshi. Ai është ish lojtar i KF Deçani që i takon gjeneratës së artë të atij klubi, ku bënë pjesë: Ramosaj, Aliqkaj, Dobruna, Dautaj e të tjerë. Ishte një gol tejet i bukur nga 16 metra me një gjuajtje si nga katapultat.

Skuadra jonë pas këtij goli disi e fitoi edhe më shumë besimin, duke atakuar pa ndalur portën mysafire. FC Liria gjatë pjesës së parë pati edhe

disa raste për shënim, por nuk arriti të shënonte më shumë se një gol. Ajo ishte më tepër e koncentruar në mesin e fushës e herë pas herë provonte ta shtonte epërsinë, mirëpo imperativ i skuadrës shqiptare ishte vetëm fitorja, arkëtimi i tri pikëve kundër konkurrentit të drejtpërdrejt për mbijetesë në këtë shoqëri. Në rastet e tilla kur takimi ka peshë të veçantë, shikuesit nuk mund të presin shfaqje të mirë futbolli.

Skuadra jonë, edhe në pjesën e dytë e mbajti topin nën kontroll, duke mos lejuar skuadrën mysafire ta rrezikojë portën e portierit Jerliu. Rezultati i ngushtë arriti të ruhej deri në minutën 55, kur mysafirët arritën të shënojnë golin e barazimit pas gabimit të veteranit Hyseni i cili ndërhyri ngathtë dhe në mënyrë naive. Ishte ky një dush i ftoftë për skuadrën tonë dhe për adhuruesit të cilët me skepticizëm e pritnin lojën në vazhdim. E mira vjen nga dalë, thotë një fjalë popul-

lore dhe kjo e mirë erdhi pikërisht në minutën e 65-të, kur një top të harkuar nga këndi nga mjeshtri Kolloni e shfrytëzoi me mjeshtri, duke e konvertuar në gol Dervishi. Dhe, erupsioni tek futbollistët dhe fansat shqiptarë për rikthimin e rezultatit ishte i pandalshëm.

Skuadra shqiptare ishte tej mase e ngarkuar para këtij ballafaqimi dhe kjo deri diku ndikoi edhe në efikasitetin. FC Liria ka mundur ta shtojë epërsinë edhe më herët sikur kapiteni Restelica të ishte më i koncentruar kur nga pozita ideale huqi rastet e volitshme. Në këtë takim ishin prezent edhe përfaqësuesit e ambasadës së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës, duke i inkurajuar futbollistët shqiptarë në këtë takim të rëndësishëm, pas të cilit u organizua një koktej enkas për futbollistët dhe përfaqësuesit diplomatikë. Këtë koktej e organizoj ish presidenti shumëvjeçar i skuadrës FC Liria, tash nënkryetar i FFSHGJ z. Sadik Murseli.

Suedi

Një shqiptar në garën "Gjuetia e sipërmarrësve"

Studentë nga gjithë Suedia do të garojnë në Göteborg në gjetjen e ideve më të mira afariste. Më 15 maj do të zhvillohet veprimtaria e quajtur Gjuetia e sipërmarrësve, Entreprenörsjakten. Ideator i një projekti të këtillë është Gustaf Josefsson. Sipas tij një garë e këtillë është domosdoshmëri e të ardhmes.

Në grupin e pjesëmarrësve garues kësaj here, për herë të parë gjendet edhe një shqiptar nga Udevalla. Fjala është për 18 vjeçarin Naim Murseli, me prejardhje nga Cërmjani i Gjakovës. Pos obligimeve shkollore Naimi ka filluar që para tri vitesh në një firmë telemarketingu të punojë nga pak ku edhe

krijon përvojat e para të punës. Pastaj vazhdon të angazhohet në hapjen e webfaqeve në internet për firma të ndryshme gjë që ka rezultuar në hapjen e një firme private në hapjen dhe dizajnimin e webfaqeve. Aktualisht zhvillon projektin e hapjes së 20 webfaqeve shqiptare. ("Jehona")

Më 9 maj në Neuchatel, Zvicër

Bëhet promovimi i romanit të Bedri Dedjes "Presidenti i pallatit të kuq"

LAPSH "Naim Frashëri", në bashkëpunim me Bashkësinë Shqiptare të Kantonit të Neuchatelit, organizon të shtunën, më 9 maj, promovimin e librit "Presidenti i pallatit të kuq", të fundit të autorit të ndjerë për fëmijë Bedri Dedja.

Të pranishmit do t'i përshëndesë Belul Bajrami, kryetar i Bashkësisë Shqiptare në Neuchatel, pastaj, në kuadër të programit, me një fjalë do të paraqitet Mahir Mustafa, koordinator i SHSHMP në Zvicër. Në vazhdim, Asllan Gjinovci do të evokojë "Kujtime me Bedri Dedjen", ndërsa Saime Isufi, arsimtare e gjuhës shqipe në Bienne do të paraqitet po ashtu me një fjalë. Krijuesi Alfred Papuçiu do të mbajë "Dy fjalë për autorin dhe për krijimtarinë e tij",

ndërsa Edlira Dedja do të lexojë vështrimin "Libri "Presidenti i pallatit të kuq" dhe vlerat e tij edukative për fëmijët".

Në vazhdim do të ketë diskutim të lirë me nxënësit e shkollës shqipe të Neuchatelit, nën drejtimin e Drita Kelmendit, mësuese e gjuhës shqipe. Do të ketë po ashtu lexim fragmentesh të librit nga nxënësit e shkollës shqipe si dhe diskutime të lira të pjesëmarrësve. Programi mbyllet nga grupi i valleve.

Aktiviteti i promovimit do të mbahet më 9 maj në Neuchatel, duke filluar në orën 17.00 në sallën e aktiviteteve kulturore të restorantit "Restaurant Tropicale - Hotel des Communes, Rue de Premier Mrs 1, geneveys-sur-Coffrane.

Cyrih: Red Star - FC Kosova 1-7

Fitore e thellë, në ndeshjen e 17 pa humbje të FC Kosovës

Përparim Bunjaku, Shukri Latifi, Visar Sylaj, Samet Pajaziti, Shpend Latifi (70' Mergim Rushiti), Ismajl Bunjaku (65' Kushtrim Xhaferi), Sefer Haxhiu, Arlind Rexhaj, Mikel Lazri, Fazli Haxhiu (62' Valon Latifi) dhe Adnan Jashari. Rezervë: Milaim Lakna, Naim Krasniqi, Azdren Avdijaj. Golat: 0:1 dhe 0:2, 4'und 9' Adnan Jashari, 0:3, 26'Fazli Haxhiu, 0:4 30'Shpend Latifi, 0:5 41'Arlind Rexhaj, 0:6 50'Fazli Haxhiu, 1:6 53'Red Star, 1:7 75'Mërgim Rushiti.

Pas një fillimi të furishëm dhe efikas, kur sapo ishin mbushur nënbtë minuta të lojës, rezultati tashmë ishte 2 me 0 për ekipin mysafir, FC Kosova. Pjesa e dytë përfundoi me rezultatin 5 me 0 për ekipin shqiptar dhe në fund, pas një "goli nderi" të shënuar nga skuadra nikoqire, ndeshja u kurorëzua me rezultatin 7 : 1 për FC Kosovën. Me këtë rezultat, skuadra shqiptare nga Cyrihu ia ka dalë që për të shtatëmbëdhjetën herë me radhë në ndeshjet kampionale dhe ato për kupë në këtë kampionat të lëshojë fushën e pamposhtur. 15 fitore dhe gjithsej dy barazime. Një sukses gjithsesi për tu mburrur.

Një fillim të tillë do ta dëshironte secili trajner futbolli. Në rastin e parë që iu dha, në minutën e katërt, Adnan Jashari me një shut të fuqishëm shënoi golin e parë për FC

dytë filloi me ritëm pothuaj të njëjtë. Sefer Haxhiu e shërbeu mirë kushërinin e vet Fazli Haxhiun, i cili nuk kishte si të dështonte dhe kështu, kosovarët shënuan golin e tyre të gjashtë, ndërkohë që nikoqirët ende nuk e kishin bërë "sefte". Kjo ndodhi në minutën e 53-të, dhe rezultati tashmë ishte 6 : 1. E gjendur në një pozicion komod, me fitore të siguruar, stafi teknik i FC Kosovës vendosi që të fuste në lojë edhe lojtarë të rinj, duke u dhënë atyre shansin për tu dëshmuar dhe njëherësh duke u krijuar mundësi të pushimit lojtarëve të formacionit të parë. Kështu, lojtari i ri Mërgim Rushiti, shënoi që në minutën e parë të inkuadrimit të tij në lojë. Dhe 7 : 1 për FC Kosova. Ishte ky një gol i mrekullueshëm nga largësia prej 20 metrash. Gol që i vuri kapakun e artë gjithë ndeshjes.



Lojtarët e FC Kosovës, pas njërit nga golat e tyre të shumtë, në një ndeshje të këtij stinori

Kosovën. Vetëm pesë minuta më vonë është sërish Jashari që shënon, duke shtuar epërsinë e skuadrës shqiptare në 2 me 0. Në minutën 26 në skenë edhe një herë doli "makina" e golave, Fazli Haxhiu, i cili, nga një pozicion i pashpresë, nga largësia prej 20 metrash, shënoi një gol të bukur. Katër minuta më vonë, pas një korneri për FC Kosovën, ngriti rezultatin në 4 me 0. ndërsa pjesën e parë të lojës, me golin e pestë për FC Ksoovën e përmbyll Arlind Rexhaj. Pjesa e

Për fund duhet thënë se të gjithë lojtarët treguan lojë dhe angazhim shumë të mirë, ndërsa golat e shumtë dhe të bukur, kënaqën publikun e tubuar në fushën Allmend Brunnau të Cyrihut. FC Kosova deri në fund të stinorit ka për të luajtur edhe shtatë ndeshje, ndërkohë që ekipit të dytë në tabelë, Kilchberg Rüsçlikon (i cili ka një ndeshje më shumë për të luajtur) i ik tashmë 10 pika. Ndeshjen e ardhshme, më 10 maj, ekipi ynë e luan më 10 maj në ora 13.30, në terren të vet, kundër FC Wiedikon.